



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë më, 30.10.2020, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Rudina Hajdari – kryetare e Komisionit

Rend i ditës

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2021”
2. Të tjera.

Marrin pjesë:

Rudina Hajdari, Senida Mesi, Arben Kamami, Taulant Balla, Klodiana Spahiu, Mirela Kumbaro, Nikolin Staka,, Fatmir Velaj,, Kostaq Papa, Vasil Sterjovski, Arlind Carcani, Edlira Hyseni, Musa Ulqini, Artemis Mara.

Mungojnë:

Sadri Abazi, Ilir Pendavinji

Të ftuar:

Adela Xhemali - Zëvendësministër e Ekonomisë dhe Financave

Mimoza Dhëmbi – Drejtor i Përgjithshëm për Buxhetin në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Hapet mbledhja

Rudina Hajdari – Mirëdita, kolegë!

Fillojmë mbledhjen. Do fillojmë duke marrë listëprezencën. Zonja Mesi, zoti Velaj, zoti Ulqini, zoti Pendavinji, zoti Kamami, zoti Balla, zonja Spahiu, zonja Kumbaro, zoti Abazi, zoti Staka, zoti Papa, zonja Hyseni, zoti Çaçani, zoti Sterjovski, zonja Mara, zonja Malo?

Dakord. Për ditën e sotme, siç e kishim parashikuar, do të shqyrtojmë buxhetin e vitit 2021. Të ftuar për të na folur mbi këtë buxhet për vitin 2021 dhe për çfarë është alokuar për integrimin e Shqipërisë, kemi prezent zëvendësministren zonjën Adela Xhemali. Si fillim do t'i japim fjalën zonjës Xhemali, për të na prezantuar me buxhetin e viti 2021, dhe më pas do të vijojmë me pyetjet nga deputetëve.

Shikoj që, zoti Ulqini dëshiron të marrë fjalën.

Musa Ulqini – Prezent.

Rudina Hajdari – Në rregull.

Pa humbur kohë, ftoj zëvendësministren, zonjën Xhemali, fjala për ju.

Adela Xhemali – Përshëndetje!

E nderuar kryetare, të nderuar deputetë,

Projektligji i buxhetit për vitin 2021 mbart një objektiv madhor, atë të rimëkëmbjes ekonomike. Është pikërisht ky objektiv që do të bëjë të mundur tejkalimin me sukses të pasojave negative prej dy fatkeqësive natyrore që kanë goditur vendin tonë, në mënyrë të njëpasnjëshme, tërmeti i datës 26 nëntor 2019 dhe pandemia e shkaktuar nga COVID-19. Pasojat negative të këtyre dy fatkeqësive natyrore janë ndier në ekonominë e vendit dhe në financat publike, ku pritshmëria jonë mbi rritjen ekonomike në fundit të vitit 2020 është në nivelin -6,1 %. Pavarësisht, kësaj ecurie që ka afektuar të gjithë vendet e botës, jemi besimplotë që në vitin 2021 ekonomia shqiptare do të kthehet në trendin normal të rritjes së qëndrueshmërisë ekonomike, ku parashikohet një rritje prej 5,5% me një trend mesatar prej 4% për periudhën afatmesme në vijim.

Por megjithatë, përveç këtij efekti të lartë negativ në ekonominë tonë, në të njëjtën kohë, patjetër duhet theksuar që situata, gjithsesi, mbetet nën kontroll. Qëndrueshmëria e financave publike përbën një tjetër fundament tejet të rëndësishëm për perspektivën e ekonomisë. Me gjithë përkeqësimin e pashmangshëm të parametrave kryesorë të financave publike, gjatë këtij viti, për shkak të pandemisë dhe pasojave të tërmetit, sërish, deri më tani duket se ky fenomen ka qenë i

qëndrueshëm, pa ndonjë problem serioz, me pasoja sistematike zinxhir në stabilitetin makroekonomik të vendit. Në vitet e fundit, financat publike kanë hyrë në një trajektore të sigurt të konsolidimit fiskal.

Së pari, kjo është materializuar në uljen e defixhitit buxhetor nga 5% e prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2013, në nën 2% deri në vitin e kaluar 2019. Po ashtu, edhe borxhi publik ka njohur trajektore të qartë rënëse në vitet e fundit, deri përpara se vendi të goditej nga pandemia, duke rënë nga rreth 73% në vitin 2015, në rreth 66,3% në vitin 2019, megjithëse në atë vit vendi u godit nga tërmeti. Po ashtu, që prej viti 2016, deri në vitin 2019, buxheti ka rirregjistruar një balancë primare pozitive, gjë e cila nuk ndodhte pothuajse në asnjë vit gjatë 3 dekadave të fundit, përveç vitit 2010.

Ndërkohë, nënkuptohet që në vitin aktual dhe në vitin e ardhshëm, si rrjedhojë e dy goditjeve të njëpasnjëshme që u përball vendi, deficitit i përgjithshëm buxhetor do të zgjerohet në nivele rreth 6%. Megjithatë, ky zgjerim i deficitit fiskal do të jetë tërësisht i përkohshëm dhe i targetuar mirë, për të amortizuar impaktin e këtyre dy goditjeve. Ndërkohë, objektivi themelor për periudhën afatmesme në përputhje të plotë me rregullat fiskale në ligjin organik të buxhetit, do të jetë rikthimi në një trajektore rënëse të borxhit publik. Njëkohësisht, në afatin e mesëm në vijim synohet dhe programohet ruajtja e një niveli të investimeve publike rreth 5% e prodhimit të brendshëm bruto në vitet 2021-2023, esenciale kjo për të mbështetur nivele relativisht të larta rritjeje në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Për sa i përket objektivit primar të konsolidimit fiskal ose thënë ndryshe të uljes së borxhit publik, treguesit e buxhetit të vitit 2021 janë si më poshtë: deficitit fiskal prej 6,55 e prodhimit të brendshëm bruto në ulje, krahasuar me të pritshmin e 2020 prej 6,8% e PPB-së. Balanca primare edhe pse sërish e parashikuar në vlerë negative prej -3,9% e PBB-së në 2021, gjithsesi është në përmirësim të konsiderueshëm, krahasuar me nivelin e pritshëm prej -4,6% në fund të vitit 2020. Balanca korrente ose thënë ndryshe, diferenca midis investimeve publike dhe deficitit fiskal, rikthehet në shifra pozitive që në vitin e ardhshëm 2021, në nivelin prej 0,8% të prodhimit të brendshëm bruto, nga një nivel i pritshëm negativ prej -0,3 % në këtë vit. Për rrjedhojë, niveli i borxhit publik do të rikthehet qartësisht trajektore rënëse në vitin 2021, me vlerë rreth 78,6% e PPB-së ose rreth 80,9% që ne kemi pritshmërinë për vitin 2020, pra, duke u rikthyer sërish te ky parametër në përputhje me përcaktimet tona ligjore.

Kjo rimarrje e rritjes ekonomike, parashikuar për vitin 2021, pritet të reflektohet edhe në tregun e punës duke gjeneruar më shumë punësim dhe rënie të nivelit të papunësisë në 12,2% në vitin 2021, krahasuar me 13,9% që pritet në fund të vitit 2020.

Në vitin 2021 të ardhurat totale të buxhetit parashikohet të arrijnë 479 miliardë lekë, nga këto të ardhura tatimore 437 miliardë lekë dhe brenda zërit të të ardhurave tatimore të ardhurat që mbliidhen nga tatimet dhe doganat 311 miliardë lekë. Ndërkohë, të ardhurat nga kontributet planifikohen 99,7 miliardë lekë. Krahasuar me të prishmin e viti 2020 të ardhurat gjithsej të buxhetit të shtetit rriten 10,6%, ndërkohë që të ardhurat tatimore nga tatimet dhe doganat programohen të rriten 12,2% ose rreth 37 miliardë lekë, dhe 2,5% krahasuar me vitin 2019, ndërkohë që rritja mesatare për vitet 2018 dhe 2019 ka qenë 3,5%.

Shpenzimet buxhetore për vitin 2021 të programuara në nivelin 587,6 miliardë lekë ose 43,9% e prodhimit të brendshëm bruto, me rritje në terma nominalë rreth 8 miliardë lekë, krahasuar me aktin normativ të buxhetit 2020 do të vijojnë të mbështesin sektorët prioritarë si shëndetësia, arsimi, bujqësia, infrastruktura, si dhe mbështetjen e plotë të procesit të rindërtimit nga tërmeti i 26 nëntorit, të cilat të marra së bashku garantojnë stimuj pozitivë për rritjen ekonomike të vendit për periudhën 2021-2023 dhe përtej, duke gjeneruar njëkohësisht punësim të qëndrueshëm.

Shpenzimet e personelit për vitin 2021, të paparashikuara në masën 92 miliardë lekë ose 5,5% e prodhimit të brendshëm bruto, reflektojnë koston aktuale të administratës publike, si dhe politikën e re të rritjes së pagave në dy sektorët prioritarë, shëndetësi me 40% dhe arsim me 15 %.

Niveli i fondit rezervë për vitin 2021 planifikohet në masën 4 miliardë lekë, përkatësisht 2 miliardë lekë fond rezervë i Këshillit të Ministrave, 1 miliardë lekë fond kontigjence për mbështetjen e procesit zgjedhor dhe 1 miliardë lekë fond rezervë për studime dhe projekte, për projektet e investimeve publike strategjike që lidhen me planin ekonomik dhe të investimeve të planifikuara nga Bashkimi Europian, për Ballkanin Perëndimor.

Investimet publike për vitin 2021 janë planifikuar në masën 7.2% të prodhimit të brendshëm bruto ose 120.6 miliardë lekë, duke përfshirë këtu dhe fondin e rindërtimit në shumën 28 miliardë lekë. Kjo shifër është dukshëm më e lartë se vlera prej 87, 8 miliardë lekë e parashikuar në aktin normativ të buxheti të vitit 2020. Në planifikimin e investimeve për vitin 2021 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm. Ashtu si edhe në vitin 2020, edhe në vitin 2021 do të ketë përparësi financimi i projekteve në vijim.

Për rindërtimin në projektbuxhetin e vitit 2021 parashikohen 28 miliardë lekë për përballimin e procesit të rindërtimit nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. Krahas kësaj shume të konsiderueshme, që përballohet nga buxheti i shtetit, gjatë vitit 2021 është parashikuar edhe një fond prej 1,5 miliardë lekë për përballimin e bonusit të qirasë për familjet e mbetura të pastreha nga kjo fatkeqësi. Krahas 34 miliardë lekëve të parashikuara për t'u shpenzuar deri në fund të vitit 2020 dhe 6 miliardë lekë të parashikuara në vitin 2022, buxheti i rindërtimi do të mundësojë 3,470 banesa individuale, 4,646 banesa kolektive dhe 145 objekte arsimore, si dhe të gjithë infrastrukturën shoqëruese të nevojshme për vënien në funksion të plotë të tyre.

Përballimi i situatës së shkaktuar nga pandemia COVID-19.

Në kuadër të pandemisë COVID – 19 qeveria shqiptare alokoi për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale një buxhet të dedikuar të menaxhimit të epidemisë në forcimin e sistemit shëndetësor në vlerën 2,4 miliardë lekë nga buxheti i shtetit për vitin 2020. Kësaj shume u shtohen dhe 507 milion lekë ndihma, kryesisht nga organizata ndërkombëtare në pajisje mjekësore, materiale mbrojtëse dhe medikamente. Prej më shumë se 6 muajsh sistemi shëndetësor ka arritur të menaxhojë deri më tani me sukses përballjen me COVID – 19 falë punës së ekipit mjekësor dhe investimeve të kryera nga qeveria dhe bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë. Për vitin 2021 kostoja totale e prioriteteve për përballimin e pandemisë COVID – 19, që do të financohet nga buxheti, është rreth 6 miliardë lekë, ku përfshihet edhe kostoja e parashikuar për vaksinën anti COVID COVAX , dhe do të garantojë një menaxhim sa më të mirë dhe efikas të pandemisë COVID-19. Këtu nuk përfshihet kostoja e rritjes së pagave prej 40% për stafin mjekësor.

Së fundi, nëse do të ndalemi te financimi i prioriteteve për integrimin në BE, fillimisht do të përmendim financimin e plotë të reformës në drejtësi që prej fillimit të saj në vitin 2016. Gjithashtu, reforma në administratën publike po vazhdon me ritme të kënaqshme dhe pritet që në vitin 2021 të finalizohet rishikimi i sistemit të pagave dhe i metodologjisë së klasifikimit të pozicioneve të punës në administratën publike.

Edhe në fusha të tjera, si transporti, bujqësia, zhvillimi ekonomik, do të avancojmë më tej përpjekjet e tyre për ta përafuar si legjislacionin e tyre parësor dhe dytësor me atë të Bashkimit European, por edhe duke ofruar asete dhe shërbime publike, të cilat shpejtojnë procesin e integritit me Bashkimin European.

Ju falenderoj për vëmendjen!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zonja Xhemali për prezantimin e buxhetit të shtetit për vitin 2021! Përpara se të fillojmë me pyetjet nga deputetët, kam unë disa pyetje në lidhje me këtë projektligj, ndaj do të kërkoja vëmendjen tuaj për sa i përket pjesës kur flitet për integrimin e Shqipërisë. Ju kërkoj që të keni pak durim dhe t'i mbani shënim në mënyrë që t'i përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

E para, cila ka qenë kërkesa fillestare për buxhet e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, për ministrinë tuaj, në lidhje me procesin e integritit europian dhe a ka ndryshuar kjo kërkesë?

E dyta, duke e mirëkuptuar faktin që kemi pasur dy fatkeqësi, tërmetin dhe gjendjen e COVID-it, nëse do të shikohen të dhënat e vitit 2018, 2019 2020 dhe 2021, kemi një ulje vit pas viti të buxhetit për procesin e integritit europian. Nga viti 2018 në viti 2021 është ulur me 50%. Pra, është një ulje e dukshme, ndërkohë që Shqipëria ka hapur negociatat dhe ka caktuar një kryenegociator. Nuk kanë lindur nevoja të reja për buxhetin e shtetit në mënyrë që ne të intensifikojmë procesin e integritit, sepse tashmë që kemi hapur negociatat do të na duhen më tepër kapacitete dhe pse nuk është reflektuar kjo në buxhet? Pse ky trend ulës për procesin e integritit, ndërkohë që procesi i integritit është një nga prioritetet madhorë të vendit tonë? Mund të them që është prioriteti i parë në vend me interes kombëtar.

E treta, pse nuk është veçuar buxheti i kryenegociatorit, sepse nuk shikoj të jetë përfshirë si zë në buxhetin e shtetit? Është përfshirë apo jo dhe nëse po, sa është?

Këto pyetje kam si fillim.

Faleminderit!

Zonja Xhemali, fjala është për ju.

Adela Xhemali – Faleminderit për pyetjet, zonja kryetare!

Këtu me mua është zonja Dhëmbi, drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit, e cila do t'u përgjigjet pyetjeve tuaja.

Mimoza Dhëmbi – Ju kërkoj ndjesë për vonesën, por ndërkohë jam edhe në Komisionin e Ekonomisë!

Për sa u përket kostove të parashikuara në buxhetin e vitit 2021 për procesin e integritit, nuk mund të themi apriori që buxheti është reduktuar, sepse buxheti nuk nënkupton thjesht disa njerëz që punojnë në Ministrinë e Jashtme ose në Kryeministri. Pra, kjo nuk përfaqëson koston e integritit, por është kostoja e njerëzve që punojnë për integrimin. Integrimi është proces më i

gjatë, i cili është i reflektuar me prioritet në të gjitha ministrinë e linjës, që kanë detyrime për të plotësuar kushtet dhe kriteret. Ky është një diskutim i gjatë që mund ta bëjmë me ministrinë përkatëse ku të nxjerrim nga çdo ministri kostot shtesë që lidhen me integrimin.

Pra, në tërësi mund të themi që në principet tona, në udhëzimet tona, në metodologjinë tonë, përfshirja e kostove të integritit ka qenë prioritet, shtu këtu edhe kërkesat për projekte që lidhen me integrimin, me kushte që duheshin plotësuar për hir të integritit, janë të plotësuara si nevoja bazike të institucioneve. Është çështje e shpenzimeve administrative të pjesës së integritit në Ministrinë e Jashtme nëse është ulur apo shtuar buxheti. Pra, janë gjëra fare minimale, sepse bëhet fjalë për buxhete administrative shumë të thjeshta. Kjo është në princip.

Rudina Hajdari – E kuptoj. Meqë jeni këtu, zonja Dhëmbi, për sa i përket asaj që thatë ju, e para dua të më thoni sa është kostoja. Dakord? E dyta, unë iu referova tabelës ndër vite. Po të shikosh tabelën ndër vite, nga viti 2018 deri në vitin 20121, ka trend ulës. Pra, kjo është një gjë e dukshme dhe ju nuk mund të më thoni që kjo nuk ka ndodhur, sepse nuk ka të bëjë me sa njerëz punojnë në administratë për procesin e integritit në mënyrë që të reflektohet që po punohet për procesin e integritit.

Nëse ne kemi një trend në ulje, ndërkohë që negociatat intensifikohen, tregon që neve na duhen akoma më shumë kapacitete njerëzore në mënyrë që kjo të ndodhë. Kjo nuk ka ndodhur në asnjë vend tjetër. Sjell në vëmendje Kroacinë apo Serbinë, buxhetet e të cilave i kam parë dhe janë në rritje në hapat që kanë ndërmarrë, sidomos kur kanë hapur negociatat. Si ka mundësi që ky buxhet në 4 vjetët e fundit është ulur, sepse nuk ka kuptim? Mund të më thoni çfarë ka ndodhur me mbështetjen institucionale për procesin e integritit?

Mimoza Dhëmbi – Më falni, cilit buxhet i referoheni, atij të Ministrisë së Jashtme në programin e integritit? Për të qenë e qartë për çfarë po flasim.

Rudina Hajdari – Po, për këtë jemi këtu. Ky është Komisioni i Integritit Europian.

Mimoza Dhëmbi - Siç ju thashë në fillim, shpenzime për integrimin kanë shumë institucione, të cilat janë të përfshira brenda programeve normale, funksionale të institucioneve të ministrive përkatëse. Ky është një program për kostot administrative, në qoftë se i referoheni Ministrisë së Jashtme në programin “Mbështetje institucionale për procesin e integritit”. Në qoftë se shikoni kostot korrente, unë kam edhe shpenzimet e buxhetit fillestar të vitit 2020 me akt normativ dhe vitit 2021, shpenzimet korrente bazë për financimin e stafit që merret me integrimin

dhe shpenzimet e tyre administrative janë me rritje, kurse janë me ulje shpenzimet kapitale që mund të lidhen me shpenzime administrative të momentet.

Për shembull, kur bën një investim për rikonstrukcion zyresh, pajisjesh ose të tjera. Kjo ka bërë që në total të duket sikur buxheti për këtë program ka rënë. Pra, unë kam të dhënat për programin “Mbështetje institucioneve për procesin e integrimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme”. Në vitin 2020 buxheti fillestar ka qenë 96 milionë, 92 milionë me aktin normativ, kurse në buxhetin e vitit 2021 janë 100 milionë. Mund t’i shikojmë edhe më gjatë ndër vite nëse doni.

Unë vazhdoj të insistoj që ky nuk përfaqëson buxhetin për procesin e integrimit, por është thjesht për punonjësit e drejtorisë së Integrimit që është pjesë e Ministrisë e Jashtme.

Rudina Hajdari – Nga viti 2018 deri në vitin 2021 ka rënë me 50%. Nuk është thjesht ashtu siç thoni ju, ndryshime të vogla që ndoshta kanë ndikuar dhe ashtu mund të duket. Si ka mundësi që ka një rënie me 50% nga viti 2018 në vitin 2021? Ka ndodhur diçka, sepse nuk ka mundësi që të jetë kaq e dukshme kjo rënie. Unë mund t’jua dërgoj tabelën.

Mimoza Dhëmbi – Pak më vonë mund ta nxjerr edhe unë tabelën me të dhënat historike për këtë program.

Rudina Hajdari – Për sa i përket kryenegociatorit, deri diku ai është ministër shteti. Pse nuk është parashikuar fare buxheti i tij në këtë buxhet? Si ka mundësi që ai nuk ka një zë në këtë buxhet shteti?

Mimoza Dhëmbi – Kostoja për kryenegociatorit është përfshirë në buxhetin e Kryeministrisë, sepse ai dhe personeli që punon për të është pjesë e stafit të Kryeministrisë. Nuk besoj se ka nevojë të dalë si program më vete brenda Kryeministrisë, sepse ai është një shpenzim administrativ i thjeshtë.

Rudina Hajdari – Dakord, do ta shikojmë. Nuk më thatë, zonjë, sa ishte kostoja. Thatë që ka një kosto për procesin e integrimit europian. Sa është kostoja që është kërkuar nga Ministria për Europën dhe Punët me Jashtë? Sa është kërkuar nga ministria, në mënyrë që ju të alokonit këtë shumë dhe më pas çfarë ndryshimi ka pasur? Dua vetëm të di nëse ka pasur ndryshim nga kërkesa e tyre dhe nga çfarë keni dhënë ju.

Mimoza Dhëmbi – E vetmja kërkesë që kemi pasur nga Ministria për Europën dhe Punët me Jashtë lidhej me anëtarësimin në Këshillin e Sigurimit. Pra, vetëm kërkesa për atë staf.

Rudina Hajdari – Sa është kostoja për procesin e integrimit europian? Sa është kërkuar për këtë vit?

Mimoza Dhëmbi – Pra, flasim për koston administrative, për të cilën nuk ka ndonjë kërkesë shtesë.

Rudina Hajdari – Nuk ka pasur, domethënë.

Mimoza Dhëmbi – Sepse kostoja totale e integritit nuk është thjesht kostoja administrative e punonjësve që punojnë në Ministri të Jashtme. Kostot e integritit lidhen me projekte që kanë të bëjnë me integritimin, me kritere dhe kushtet që duhen arritur me përgatitjen e legjislacionit e të tjera. Nuk është se ka kosto të pakërkuar.

Rudina Hajdari – Në Ministrinë për Europën dhe Punët me Jashtë duhet të ketë një administratë, e cila punon vetëm për procesin e integritit europian, apo jo?

Mimoza Dhëmbi – Nuk ka kërkesë të paplotësuar.

Rudina Hajdari – Nuk keni kërkesë të paplotësuar.

Mimoza Dhëmbi – Flas brenda Ministrisë së Punëve të Jashtme, flas për integritimin.

Rudina Hajdari – Po, folët në fillim të fjalës suaj dhe thatë që procesi i integritit europian ka një kosto të caktuar...

Po, po, shteti shqiptar. Sa është kjo kosto? Sa është?

Mimoza Dhëmbi – Nuk është kaq e thjeshtë për të thënë që kostoja është kjo, sepse mund të jetë kosto që lidhet me Ministrinë e Bujqësisë, mund të ketë kosto që lidhen me Ministrinë e Drejtësisë, mund të ketë kosto që lidhen me transportin. Domethënë, çdo ministri ka në vetvete kostot e integritit të ndërthurura me kostot normale të funksioneve që ajo përmbush. Nuk është kosto e veçantë që e shikon veças. Nuk mund ta shikosh veças koston. Ajo është pjesë...

Rudina Hajdari – Dakord, dakord.

Mimoza Dhëmbi – Edhe ne, kur shkruajmë udhëzimet, gjithnjë...

Rudina Hajdari – Ndoshta nuk e keni në dispozicion aty, por a mund të na e jepni këtë informacion?

Mimoza Dhëmbi – Nuk besoj se është e lehtë, por...

Rudina Hajdari – Pse nuk është e lehtë? Si ka mundësi që nuk është e lehtë?

Mimoza Dhëmbi – Se i duhet procesit...

Rudina Hajdari – Pse nuk është transparente kjo gjë? Ne deputetët e Komisionit i Integritit Europian duam ta dimë këtë se sa alokohen për procesin e integritit europian.

Mimoza Dhëmbi – Kjo është e vështirë, pasi nuk është se është e ndarë nga pjesa normale e aktivitetit dhe funksioneve të ministrive dhe institucioneve përkatëse. Pra, është e ndërthurur me kostot normale të...

Rudina Hajdari – Ne kemi pasur Ministri të Integritit dhe kostoja ka qenë e alokuar në mënyrë... Ka pasur një zë në buxhetin e shtetit. Po tani si ka mundësi që nuk është e ndarë? Pse nuk është e ndarë? Është një proces i veçantë dhe jo një proces si gjithë të tjerët.

Mimoza Dhëmbi – Nuk kishte. Në këtë ministri nuk alokonin të gjithë koston e integritit. Ministria e Integritit ishte një ministri koordinatore e procesit të integritit. Kështu që çdo ministri kishte fondet e veta për të plotësuar detyrimet e integritit. Në atë rast, domethënë Ministrinë e Integritit e zëvendësoi kjo strukturë, që është brenda Ministrisë së Jashtme tani. Për këtë po flasim. Në vend të një ministrie, kemi këtë programin këtu. Ky programi i plotëson nevojat normale të strukturës që merret me integritimin. Pastaj kostot e integritit. Kur flasim për kostot e mëdha të shtetit shqiptar, çdo ministri...

Rudina Hajdari – Për atë po flasim sot, për kostot e shtetit shqiptar për procesin e integritit european...

Mimoza Dhëmbi – Nuk e ndajmë dot.

Rudina Hajdari – ...se jemi në Komisionin parlamentar të Republikës së Shqipërisë dhe po flasim për integritimin european, nuk po flasim për gjë tjetër.

Mimoza Dhëmbi – Po pra, këtë po ju sqaroj që çdo ministri, edhe në udhëzimet tonë, në metodologjinë tonë, e ka prioritet. Çdo gjë që lidhet me integritimin është parësore dhe quhet shpenzim bazik, shpenzim që është i detyrueshëm për t'u parashikuar. Se sa është ky shpenzim nga shpenzimet e tjera normale, kjo është e vështirë për ta ndarë në pjesë, sepse ne kemi planifikim buxhetor...

Rudina Hajdari – Pse është e vështirë? Më gjen dot një përgjigje pse është e vështirë? Sepse në momentin kur ju thoni që është e vështirë, thoni pastaj që është e vështirë, sepse është e ndarë në këto ministritë e tjera, ka disa fonde të alokuara për këtë ministri, të Bujqësisë, atë tjetrën, më pas, kur unë jua kërkoj këtë si informacion, ju nuk ma jepni dot, se është e vështirë edhe kjo. Si ka mundësi? Pse është kaq e vështirë?

Mimoza Dhëmbi – Për shembull, një kusht i integritit mund të jetë reforma në drejtësi ose financimi normal i institucioneve të drejtësisë. I gjithë buxheti i institucioneve të drejtësisë mund të quhet kosto e integritit, për shembull, institucionet e reja të drejtësisë? Kostoja e SPAK-

ut, e BKH-së, Gjykata Kushtetuese e të tjerë. Pra, kushtet nuk janë kaq të thjeshta për të ndarë koston e integritit nga kostoja normale e funksionimit të institucioneve të shtetit shqiptar. Kjo është ideja.

Rudina Hajdari – Po, mund të jetë pjesë.

Mimoza Dhëmbi – Po flasim për tërësi. Mund të pyeten ministri të ndryshme, sektorë të ndryshëm se si i kanë plotësuar kriteret e integritit, si i kanë plotësuar prioritetet e integritit. Ky mund të jetë një diskutim tjetër. Mund të thërrasësh disa ministri kryesore dhe të pyeten se si i kanë plotësuar detyrimet që kanë në raport me integritimin. Sa të financuar janë për ato detyrime që kanë pasur? Ky mund të ishte një diskutim tjetër.

Mirela Kumbaro – Zonja kryetare, a mund të them diçka?

Rudina Hajdari – Po, zonja Kumbaro.

Mirela Kumbaro – Ndoshta mund t'i vij në ndihmë debatit që të mos ndalemi vetëm te një pikë, ndaj më lejoni të ndaj pak me ju eksperiencën si ish-ministre e Kulturës, ku si të gjitha ministritë e tjera në qeveri ka një Drejtori të Integritit. Secila ministri, sipas sektorit të vet, ka disa detyra, duke filluar që nga menaxhimi i projekteve IPA, që janë pjesë e detyrës sonë në procesin e integritit europian, deri te ndjekja e detyrimeve, e pikave të marrëveshjes e me radhë. Të gjitha këto janë të përfshira në fond pagash, në shpenzime administrative, në fondin që çdo ministri vë si kuotë të detyrueshme për pjesëmarrjen në projektet IPA. Unë besoj që, nëse ne duam një përgjigje të tillë, fare mirë ne mund të thërrasim ose ministrin në detyrë për Europën dhe Punët me Jashtë, ose zëvendësministrin përkatës që, pa diskutim, besoj se i ka të kontabilizuara dhe të kalkuluara përllogaritjet në raport me projektet, në raport me detyrat që ne kemi, në raport me ndjekjen, me përkthimin ose me zbatimin e direktivave të *acquis*-së në legjislacionet tona sipas fushave: bujqësia, kultura, arsimit e kështu me radhë.

Në këtë kontekst, unë e mirëkuptoj insistimin e dy zonjave të Ministrisë së Financave, të cilat nuk mund ta kalkulojnë në këtë moment, sepse nuk besoj se kjo mund të jetë një përgjigje që vjen menjëherë. Ne mund të thërrasim një seancë të përshtatshme për këtë me ministrin përkatës dhe ta kemi këtë përgjigje.

Me kaq doja vetëm të shpjegoja pse ky zë është i shpërndarë në shumë zëra dhe linja të tjera të buxhetit të shtetit: ministri për ministri, drejtori për drejtori e kështu me radhë.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Po, ne do të kemi ministrin në detyrë për Europën dhe Punët e Jashtme, i cili do të vijë dhe do të flasë për buxhetin e shtetit dhe do ta diskutojmë nen për nen. Por është e drejta ime të pyes Ministrinë e Financave se sa është kërkuar nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme për procesin e integrimit europian dhe besoj që është në interesin e të gjithë deputetëve këtu për ta ditur se sa është kostoja e procesit të integrimit.

Mirela Kumbaro – Po pra, por nuk është vetëm Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, zonja kryetare, këtë po them, sepse çdo ministri ka zërin e saj lidhur me procesin e integrimit. Nuk e ka vetëm Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme.

Rudina Hajdari – Dakord, por...

Mirela Kumbaro – Ministria mund të ketë të dhënat, por pastaj hajde t'i marrim të gjitha ministritë me radhë ose drejtoritë e integrimit.

Rudina Hajdari – Nuk po marr absolutisht asnjëlloj përgjigjeje. Kjo është e keqja. Minimumi mund të më përgjigjen për këtë se sa është kërkuar. Sa është kostoja? Nuk kam dëgjuar një shifër. Më kupton?

Mirela Kumbaro – Kuptoj atë që thashë, se e kam nga përvoja e drejtpërdrejtë. Megjithatë, patjetër që ju keni të drejtë të bëni pyetjen tuaj, sikurse kemi edhe ne të drejtë të japim një shpjegim.

Rudina Hajdari – Mua më shqetëson fakti që trendi ka ardhur në ulje, prandaj më shqetëson, sepse ne jemi duke e intensifikuar procesin e integrimit europian: sapo kemi hapur negociatat, metodologjia ka ndryshuar. Por unë nuk shikoj absolutisht asnjëlloj reflektimi përse ka ndryshuar metodologjia dhe sa ndikon kjo në buxhetin e shtetit. Pra, si është projektuar kjo gjë? Domethënë, nuk shikoj asnjëlloj transparence në lidhje me këtë pikë.

Mirela Kumbaro – Unë nuk do ta quaja mungesë transparence.

Rudina Hajdari – Totalisht mungesë transparence që përse ka ardhur kjo ulje, pra me 50%, nga 2018-a në 2021-shin, ndërkohë që procesi i integrimit është një nga prioritetet kryesore të këtij vendi.

Po, deputeti Gjoni. Fjala është për ju.

Ralf Gjoni – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, arrij t'i mirëkuptoj të dyja palët.

Ju mirëkuptoj ju, zonja kryetare, kur kërkon të keni një ide në cilësinë tuaj si kryetare e Komisionit të Integrimit, se është një pyetje e thjeshtë: sa kushton integrimi? Unë besoj që, pavarësisht se në eksperiencën e madhe të zonjave, të deputetëve dhe të përfaqësuesve socialistë

që kanë në tri dekada për të kamufluar, për të nënqeshur me ironi, me cinizëm, se “gjoja është e komplikuar”, “kjo nuk arrihet, se”, “dëgjo, se”, “këtu është pak e vështirë” e të tjera, besoj që pyetja është shumë e thjeshtë: sa kushton integrimi, zonja të nderuara të Ministrisë së Financave? Pra, “*How much does it cost?*”, është një pyetje bazike normale, të cilën ne nuk e bëjmë mjaftueshëm shpesh në Shqipëri, dhe kjo vlen për të gjitha dikasteret. Unë besoj që Ministria e Financave duhet të ketë një përllogaritje të përafërt për të parë se sa për qind e buxhetit të shtetit harxhohet në burime njerëzore, në burime financiare, në udhëtime, për të kalkuluar një kosto të përafërt se sa i kushton integrimi kësaj republike.

Nga ana tjetër, zonja kryetare, më lejoni të them dy fjalë edhe për këtë punën e transparencës. Është e vërtetë që ka mungesë transparence nga shumë institucione, por ka mungesë transparence edhe nga institucionet ndërkombëtare, që punojnë në Shqipëri. Pra, në qoftë se ne do të marrim vetëm koston e integritit, duhet të mos shohim vetëm buxhetin e shtetit, por të shohim edhe buxhetet e taksapaguesve europianë, që hidhen në fonde, të cilat menaxhohen nga njerëz të dyshimtë dhe shpërndahen në mënyra të dyshimta, pa asnjë lloj transparence. Unë, si anëtar i Komisionit të Integritit, nuk e kam idenë se ku shkojnë paratë, eurot dhe donacionet apo fondet që shpërndahen nga vendet e Bashkimit Europian në vende si Shqipëria. Në qoftë se unë futem në faqen e Delegacionit Europian nuk kam asnjë mundësi të marr informacion se ku shkojnë lekët e taksapaguesve francezë, gjermanë, belgë e të tjerë. Ndërkohë, kur flasim për qeverinë shqiptare, ne kemi zonja të nderuara të Ministrisë së Financave, të cilat, në fakt, i mirëkuptoj, e kanë të pamundur për ta përllogaritur për momentin. Kështu që, duhet të jemi të sigurtë me njeri-tjetrin, të gjithë ne, si deputetë, që përpara se të bëjmë pyetje se sa kushton ky integrim dhe sa duhet të kushtojë integrimi ne duhet të dimë se çfarë kërkojmë nga integrimi, sepse në qoftë se integrimi do të kushtojë aq sa për t’u bërë reklamë 2-3 individëve, qofshin ata deputetë, kryeministër, ministër në detyrë apo ndonjë ambasador tek tuck, që i pëlqen të hidhet si Mic Sokoli me flamur në dorë, sikur po shpërndan mrekullinë e integritit të Europës në vende si Shqipëria, atëherë unë nuk kam asnjë interes për të ditur sa kushton integrimi apo të merrem me integrimin europian.

Kështu që, unë mendoj se, meqenëse ne kërkojmë të shohim se sa kushton integrimi, duhet të shohim edhe me sa efikasitet dhe çfarë cilësie kanë sjellë harxhimet e buxhetit të shtetit, por edhe të fondeve europiane në funksion të integritit europian të Shqipërisë. Ajo që është e vërtetë dhe është fakt, është se në 11 vjet ne jemi shumë herë më keq sot me integrimin europian sesa ishim në vitin 2010 apo 2011. Jemi shumë herë më keq si nga ana e përkushtimit të qeverisë

shqiptare, ashtu edhe nga ana e përkushtimit të qeverive europiane, të cilat vazhdojnë të luajnë me ne, të tallen me popullsinë shqiptare, të na mbajnë derën mbyllur si qenër që presim ndonjë kockë dhe duke na mbajtur me gënjeshtër. Kështu që, zonja kryetare, unë jam dakord me ju, Ministria e Financave duhet të paraqesë, unë sugjeroj me shkrim, një përlogaritje të përafërt se sa është kostoja e integritimit europian, duke bërë një analizë ndërinstucionale.

Nga ana tjetër, zonja kryetare, përfitoj nga rasti t'ju sugjeroj, nuk e di sa e keni të mundur, që të ftojme pranë Komisionit të Integritimit Europian edhe përfaqësues të delegacionit Europian në Shqipëri, ku të bëjmë një bashkëbisedim të hapur edhe me ata për sa u përket parave që hidhen nga Europa. Unë kam shumë dëshirë të di se ku shkojnë milionat e Bashkimit Europian dhe...*(Ndërprerje)*

Rudina Hajdari – Kishit një moment që u shkëputët, por besoj se e mbaruat fjalën tuaj, apo jo?

Ralf Gjoni - Më falni, a e dëgjuat në fund kërkesën time për të ftuar...

Rudina Hajdari - Jo, mund të na e thoni edhe një herë.

Ralf Gjoni - Ndjesë!

Për ta përmbledhur. Unë jam dakord me ju, që të na dërgohet një përlogaritje e përafërt e koston së përgjithshme të procesit të integritimit europian, me një analizë ndërsektoriale dhe ndërinstucionale, në mënyrë që edhe ne, si parlament, të kemi një ide sa harxhon qeveria e Republikës së Shqipërisë për këtë integrim madhështor, me të cilin po spërkatën dhe po lundrojnë qytetarët shqiptarë.

Zonja kryetare, unë kam një kërkesë për ju dhe për nënkryetaren, zonjën Mesi. Mendoj se, pasi të kemi shqyrtuar buxhetin, të bëjmë edhe një seancë dëgjimore me përfaqësues të delegacionit të BE-së, ndoshta edhe me ambasadorin Soreka, nëse ai do të pranojë, ose, në mungesë të tij, me përgjegjës të delegacionit Europain në Tiranë, sepse kam shumë dëshirë të kuptoj se ku shkojnë paratë europaine në Shqipëri, çfarë transparence ka, si shpërndahen këto dhe në çfarë duarsh përfundojnë këto miliona euro të taksapaguesve europianë. Nëse ju nuk i ftoni, unë do ta vazhdoj i vetëm betejën, ose me kolegë të tjerë deputetë, për të gjetur të vërtetën se ku shkojnë fondet europiane në Shqipëri. Pra, duhet të shohim nga të dyja anët, nga njëra anë, se ku shkojnë paratë shqiptare dhe, nga ana tjetër, ku shkojnë paratë europaine dhe se çfarë po ndodhë me këtë integrim, i cili nuk po ndodh.

Faleminderit!

Rudina Hajdari- Faleminderit, zoti Gjoni!

Zonja Mesi, fjala për ju.

Senida Mesi - Përshëndetje të gjithëve!

Faleminderit, zonja kryetare!

Dua të bëj një sqarim apo një qasje më konstruktive në lidhje me trajtimin e buxhetit që po bëjmë sot.

Në lidhje me buxhetin e shtetit, sot është seanca e parë, pra është diskutimi në parim për buxhetin, i cili ka qenë prioritet i qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe i Këshillit të Ministrave, pikërisht në një situatë post tërmet dhe në një situatë pandemie, duke përcaktuar prioritetet për investimet dhe zhvillimin në vitin 2021, të cilat na i bëri të qarta zonja zëvendësministre dhe na i paraqiti në terma të përgjithshëm, kuptohet për sa kohë po e diskutojmë në parim.

Lidhur me atë sesi ndërtohet buxheti dhe me ligjin për buxhetin, sigurisht që buxhetet (këtu kemi prezent drejtoreshën e Buxhetit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila është më eksperte se secili prej nësh këtu) përcaktohen në bazë të programeve buxhetore, nga njëra anë, dhe në kërkesat e secilës ministri, nga ana tjetër.

Mua nuk më duket aspak pyetje e thjeshtë se sa kushton integrimi, sepse edhe unë mund të bëj disa pyetje, si për shembull, sa kushton zhvillimi ekonomik i Shqipërisë, sa kushton rritja e punësimit në Republikën e Shqipërisë, sa kushton ulja e deficitit, sa kushton rritja e eksporteve apo sa kushtojnë edukimi dhe mjekësia? Pra, nuk është aq e thjeshtë dhe nuk mendoj se duhet të shohim vetëm buxhetin e një ministrie linje për të përcaktuar se sa është kostoja e zhvillimit ekonomik, social dhe shoqëror të një kombi.

Sigurisht, secila nga ministrinë e linjës kanë zërat e tyre buxhetore. Pyetjet tuaja, zonja kryetare, si dhe pyetjet e mia, sigurisht, do t'i bëjmë për Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, për sa kohë ato kanë lidhje me pjesën e integritit, por rekomandoj të bëhen edhe për Ministrinë e Financave, duke qenë se është një detyrë ndërinstitucionale në shumë ministri linje dhe jo vetëm, duke filluar që nga Kryeministria, institucionet e varësisë së Kryeministrisë dhe me ministrinë e linjës për të përcaktuar një shifër apo një kosto se sa kushton integrimi. Ky është një ushtrim, që do t'i duhet kohë e mjaftueshme Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, si dhe Komisionit të Integritit European për të krijuar një metodologji për matjen e kësaj kostoje. Por, në kuadrin e ligjit dhe projektligjit që po shqyrtojmë për buxhetin, ky nuk është një detyrim ligjor apo një matje se sa kushton në Republikë e Shqipërisë

integrimi, zhvillimi, edukimi, punësimi e të tjerë, sepse janë programe buxhetore, të përcaktuara në secilën prej ministrive të linjës.

Lidhur me koston e brendshme të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, sigurisht që ne kemi një buxhet, nëse nuk gabohet, që është diku 2,6-2,7 miliardë lekë për vitin 2021, i cili merr parasysh edhe shpenzimet korrente, edhe shpenzimet kapitale, domethënë, shpenzimet që ndodhin në Republikën e Shqipërisë dhe shpenzimet në mbështetje të trupës diplomatike jashtë Shqipërisë. Në këtë sens, unë do të doja që në një moment tjetër, kur të shqyrtohet projektligji për buxhetin nen për nen me Ministrinë e Jashtme të shohim se sa i mbulon nevojat e Shqipërisë buxheti jo vetëm për procesin e integritit, por edhe përfaqësimin tonë në fushën diplomatike jashtë shtetit.

Lidhur me strukturat, më vjen natyrshëm të evidentoj një element shumë të rëndësishëm, nuk janë krijuar struktura të reja, nga zeroja, për pjesën e integritit në Bashkimin Europian, është krijuar një strukturë e re, e vetme, nëse mund ta quaj strukturë, kryenegociatori me ekipin dhe stafin e tij, ndërkohë që njësitë e tra administrative, pra departamentet përkatëse, njësitë e fondeve IPA apo pjesa e drejtorive, që janë marrë gjerësisht dhe kanë funksion kryesor brenda përbrenda Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, janë po të njëjtat strukturat, të cilat, për hir të hapjes së negociatave për aksesim dhe në momentin e zhvillimit të Konferencës së parë Ndërqeveritare me Bashkimin Europian, do të jenë struktura, të cilat do të orientohen, delegohen, komandohen, organizohen dhe koordinohen nga kryenegociatori, shpenzimet e tij dhe të ekipit të tij, të cilat do t'i përmendë edhe Ministria e Financave, do të jenë brenda buxhetit të Kryeministrisë.

Ndërkohë, në programet buxhetore të parashikuara në buxhet është edhe zëri përkatës për Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, mbështetja institucionale për procesin e integritit, ku janë alokuar mbi 200 milionë lekë të rinj, nga të cilat gjysma janë shpenzime korrente, të cilat i përkasin financimit tonë të brendshëm, kemi edhe financim të huaj prej 80 milionë lekësh. Pra, janë parashikuar edhe shpenzimet në total, në bazë të kërkesave që ka bërë edhe ministria e linjës.

Rekomandimi në rastin konkret për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është suporti që mund t'i bëjmë Komisionit për Integritin Europian për të evidentuar, në bazë të metodologjisë së tyre, se sa mund të jetë kjo kosto, duke marrë zëra të ndryshëm brendapërbrenda institucioneve përkatëse, por nuk është një ushtrim i lehtë, nuk është detyrë ligjore e Ministrisë së Financave dhe as në linjë me ligjin "Për buxhetin në Republikën e Shqipërisë". Këtë gjë ne duhet ta kemi të ndarë midis nesh, por të kemi edhe mirëkuptimin e palëve.

Në lidhje me observacionin që i bëri zotit Gjoni për fondet e Bashkimit European, sigurisht, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë është i ngarkuar me detyrën kushtetuese për të monitoruar buxhetin dhe institucionet në Republikën e Shqipërisë. Pra, kur flasim për buxhet, flasim për të ardhura, të cilat gjenerojmë në Republikën e Shqipërisë dhe këto të ardhura shkojnë qofshin për shpenzime korrente apo kapitale. Nëse do të donim një informacion, patjetër që nuk na pengon askush për t'i kërkuar informacion delegacionit të Bashkimit European në Shqipëri për pjesën tjetër të fondeve. Ju e dini shumë mirë që një pjesë e konsiderueshme e këtyre fondeve janë nëpërmjet fondeve IPA, të cilat dizbursohen nëpërmjet programit të përcaktuar në ministritë e linjës dhe për pjesën tjetër të fondeve sigurisht që vetë institucionet e Bashkimit European, vetë Parlamenti European kanë mekanizmat e monitorimit dhe të auditit të shpenzimeve. Pra, në fund të ditës, ashtu sikurse ne, banorë dhe qytetarë të Republikës së Shqipërisë kemi nderin e përfaqësimit, pra për të qenë anëtarë të Kuvendit të Shqipërisë, monitorojmë dhe kemi detyrë funksionale kontrollin e këtyre shpenzimeve në Republikën e Shqipërisë, e njëjta gjë vlen edhe për pjesën e Parlamentit European, ku secili nga vendet anëtare në Bashkimin European kanë pikërisht të njëjtën kërkesë dhe të njëjtën pritshmëri në lidhje me ku shkojnë investimet, lekët, taksat, eurot e taksapaguesve të vendeve anëtare të Bashkimit European. Pra, nuk i takon Kuvendit t'i kërkojë llogari, patjetër që Kuvendi dhe anëtarët e tij duhet të marrin më tepër informacion; pra absolutisht që duhet të kemi një bisedë më të zgjeruar e më transparente, por jo kërkesë llogarie. Kërkesë llogarie mund t'u kërkojë institucioneve në Republikën e Shqipërisë që Kuvendi ka për detyrë t'i monitorojë e t'i kontrollojë.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zonja zëvendëskryetare!

Ralf Gjoni – Zonja kryetare, a mundem për sqarim?

Rudina Hajdari – 1 sekondë, sepse dua të komentoj diçka edhe unë!

Senida Mesi – Zoti Gjoni, nuk besoj se është momenti për replikë. Ju kishit opinionin tuaj dhe unë dhashë opinionin tim.

Ralf Gjoni – Nuk e kam replikë, zonja Mesi.

Rudina Hajdari – Ju lutem, mos na shpërqendroni!

Dua të them se, së pari, nënkryetarja dhe një lloj përgjigje apo mbështeti zonjat përfaqësuese nga Ministria e Financës, pra ato që thanë në lidhje me faktin se nuk arrijnë të bëjnë

dot një lloj përlllogaritje për sa i përket procesit të integrimit. Nënkryetarja theksoi se nuk mund të matet nga vetë shteti, sepse është e pamundur, pra nuk ka një kosto të tillë. Unë kështu e kuptova.

Senida Mesi – Zonja kryetare, të gjithë e dëgjuan çfarë thashë unë dhe nuk ka nevojë të perfrazohet diskutimi që bëra. Nëse ke nevojë për kosto, ke shifrat. Buxheti për vitin 2021 në Republikën e Shqipërisë ka në total shpenzime 587 miliardë lekë, nga të cilat kostot korrente së bashku me shpenzimet kapitale shkojnë diku te 340 miliardë lekë. Kjo mund të ishte edhe një kosto e integrimit, patjetër. Kjo është kostoja për rindërtimin e Shqipërisë, për integrimin e Shqipërisë, për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe për kohezionin social.

Rudina Hajdari – Faleminderit!

Senida Mesi – Nëse keni kërkesa konkrete... Unë kam kërkesa konkrete dhe do t'ia dorëzoj sekretariatit të komisionit me shkrim që t'i jap kohën e mjaftueshme për përlllogaritje dhe përgjigje jo vetëm Ministrisë së Financave, por kryesisht Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme për ta na sqaruar me detaje nëse i kanë fondet e mjaftueshme për përfaqësimin e diplomacisë në vendet ku kemi përfaqësi.

Së dyti, nëse komplet në grupet intersektoriale dhe institucionale, që nuk janë vetëm në varësi të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, por janë grupe pune, të cilat funksionojnë në çdo ministri linje kemi burimet njerëzore të mjaftueshme, kam burimet njerëzore të mjaftueshme, sigurisht që këto burime njerëzore janë të buxhetuara me paga dhe me shpërblime apo me pjesën e pagesës së sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Rudina Hajdari – Zonja Mesi, e kuptoj shumë mirë!

Në fakt, arsyeja që unë përsërita ishte thjesht të kuptoja se çfarë po thoshit ju. Thjesht ishte një lloj mënyre për ta mirëkuptuar atë që thatë. Kjo është një gjë e mirë, besoj, për të pasur unë si kryetare një bashkëpunim sa më të mirë me ty si nënkryetare. Prandaj u mundova të kuptoja se çfarë donit të thoshit me atë që thatë. Ndoshta e kisha kuptuar gabim, ndaj ju dhashë mundësinë për t'u shprehur në lidhje me këtë. Duhet të kuptoni që ju sërish nuk iu përgjigjët, ose bëtë replikë me mua në lidhje me atë që unë thashë, pra e përdorët këtë moment më shumë për të shpjeguar se çfarë bën Ministria e Financave se sa për të monitoruar pikërisht mekanizmin që kemi në këtë komision ndaj pushtetit ekzekutiv për të na treguar se çfarë po ndodh me procesin e integrimit. Prandaj, kur flasim për integrimin e Shqipërisë, duhet të jemi në një krah. Pavarësisht nëse jemi në opozitë apo në maxhorancë, duhet që të gjithë anëtarët e Komisionit të Integrimit të shikojmë me vëmendje se sa buxhet kemi ne dhe kjo duhet t'ju shqetësojë të gjithë jo vetëm mua apo zotin

Gjoni apo këdo tjetër që është në opozitë. Pra, duhet të jemi të gjithë në një zë që të jemi konsistentë për atë që kërkojmë. Edhe kur dalim jashtë themi hajdeni të flasim në një zë për sa i përket integritit dhe reformave që ndodhin në Shqipëri, por duhet të flasim nën një zë kur shikojmë që procesi i integritit europian po ulet vit pas viti, pra buxheti i shtetit i po ul kostot vit pas viti. Pra, nga viti 2018 në vitin 2021 është ulur buxheti i shtetit për procesin e integritit me 50%. Kjo shifër për mua është alarmante, sepse presupozohet që në momentin kur shkrihen dy ministritë në një, pra Ministria e Integritit me Ministrinë e Europës u bashkëngjiten në njëra-tjetrën, unë shikoj që kostoja, në vend të ngriher po ulet, kjo gjë mua më duket alarmante.

Mirela Kumbaro – Janë kosto administrative, zonja Hajdari, nuk është ulje buxhetit për integritimin.

Rudina Hajdari – Ky është një shqetësim që kam jo thjesht duke qenë në opozitë, por e kam për të gjithë ata njerëz që sot duan të ecin përpara në procesin e integritit europian, sepse janë 90% e shqiptarëve që duan që ky proces të ecë. Por kur unë shikoj se kjo nuk reflektohet në buxhetin e shtetit, atëherë si mund të di unë sa serioz është shteti në lidhje me këtë proces integritimi? Ndaj është detyrë dhe në të mirën e të gjithëve që ta shikojmë këtë buxhet dhe të jemi të gjithë të shqetësuar, njësoj siç jam unë. Nëse më thuhet mua sot që ne nuk jemi në gjendje të përlllogaritim se sa është kostoja e procesit të integritit europian, sepse qenkan struktura të ndryshme dhe ne nuk i gjetkemi dot strukturat për çdo ministri për të treguar se sa i jepet çdo ministrie për të llogaritur për të gjitha strukturat e ndryshme ndërinstitucionale se sa është për secilën prej tyre! Pse nuk e përlllogarisim dot ne? Sepse këtu nuk punohet, këtu ka një lloj paaftësie. Transparencë jo e jo, pra kjo është nga mungesa e paaftësisë që ekzekutivi për të na treguar vërtet se çfarë po bën në lidhje me procesin e integritit europian.

Kështu që, nëse kërkohet nga institucionet e tjera që nuk varen nga ekzekutivi, të paktën minimumi në buxhetin e shtetit kjo duhet të jetë e reflektuar se çfarë po bën sot ky shtet, ky ekzekutiv që e ka si prioritet madhor procesin e integritit europian e nuk na tregon sot pse po e ul buxhetin për këtë dikaster, pra buxhetin për procesin e integritit europian vit pas vit, sepse nuk ka kuptim. Unë sot nuk mora absolutisht asnjë lloj përgjigje.

Zonja Hyseni, ka kërkuar fjalën.

Edlira Hyseni – Përshëndetje!

Doja të bëja një ndërhyrje të shkurtër, meqenëse sapa dola nga Komisioni i Ekonomisë dhe një ndër debatet që bëmë apo pyetjet e përgjigjet që i drejtuam ministres së Financës ishte për

buxhetin e ulur për Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, sepse efektivisht ka një rënie të fondeve të parashikuara për vitin 2021, diku në 616 milionë lekë të reja ose 5 milionë euro më pak.

Në fakt, pyetja lidhej pak a shumë me atë që ju, zonja kryetare, nëse kjo ulje e mëtejshme e buxhetit për këtë ministri na penalizon, ose a i prek në ndonjë mënyrë proceset integruese ose të gjitha procedurat e nevojshme që janë në kuadër të punës që Shqipëria po bën për vijimin e diskutimit të anëtarësimit. Nëse shikojmë zërat e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, realisht janë ulur të gjithë. Domethënë, janë prekur me ulje të gjithë zërat, por dy zërat kryesorë, që janë pakësuar, janë: mbështetja institucionale për procesin e integritit dhe mbështetja diplomatike jashtë vendit. Këta janë dy zërat që janë ulur në këtë ministri. Në fakt, ka një zë në buxhetin e Ministrisë së Jashtme që quhet mbështetja institucionale për procesin e integritit dhe shkon diku në 200 milionë lekë të rinj si vlerë e buxhetuar për vitin 2021, por ka një rënie me 400 mijë euro për këtë parashikim. Kështu që efektivisht zëri që duket sikur është i lidhur me këtë proces ka një rënie të parashikuar. Në fakt, rënien më të madhe e ka zëri i mbështetjes diplomatike jashtë vendit. Kjo vlen për t'u diskutuar. Unë nuk mendoj se është thjesht procesi i integritit që duhet të na preokupojë, sepse unë mendoj se është realisht një llogaritje komplekse të arrijmë të themi se sa është buxheti vjetor, le të themi, për procesin e integritit, sepse mund të konsiderojmë, për shembull, që edhe puna e zotit Dedë Kasneci, që bën përafrimin e legjislacionit, është në kuadër të proceduarve që ne ndjekim në këtë proces integriti. Kështu që edhe vlera e punës së tij, le të themi, është pjesë e proceseve që ne po bëjmë. Çdo institucion ka zërat e vet dhe ka mënyrat e veta se si përafrohet në këtë proces. Kështu që nuk është vetëm preokupimi për procesin e integritit, mendoj unë, por është edhe përfaqësimi i Shqipërisë në nivel ndërkombëtar, pra një ulje kaq e fortë... Në fakt, m'u dha një përgjigje dhe unë dua ta them që, nuk e di nëse në fillim të mbledhjes, do të më falni, sepse nuk isha në momentet e para, se isha në Komisionin e Ekonomisë, ministrja e Financave na dha shpjegimin që kjo rënie e fortë shpjegohet me fondet e një viti të mëparshëm, që lidheshin me kryesimin e OSBE-së në këtë vit. Pra, zëri që ka më shumë rënie lidhet, në fakt, me një shpenzim më të ulët për faktin e kryesimit të OSBE-së nga Shqipëria. Pra, ka qenë një fond më i lartë, që nuk është më i nevojshëm gjatë këtij viti, të paktën këtë shpjegim më dhanë, por unë edhe një herë i pyes përfaqësuesit e ministrisë: këto fonde të parashikuara në rënie në të gjithë zërat e kësaj ministrie, efektivisht, e thashë, të gjithë zërat janë prekur në ulje, a na penalizojmë dhe a rrezikojmë? Ama, duhet të kemi parasysh që jemi në një vit krize, në një vit recensionin, ku parashikimet e vitit të ardhshëm janë përpjekur për të qenë optimiste, por, gjithsesi, është

preokupimi i madh që do të kemi vështirësi financiare, prandaj mundet që të jetë ndikuar edhe nga situata në të cilën ne jemi, por unë përsëri pyes zëvendësministren: a mendoni që kjo ulje e ndjeshme e buxhetit, që i takon kësaj ministrie, në njëfarë mënyre, mund të penalizojë proceset që ne kemi në kuadër të anëtarësimit në BE apo sidomos edhe të përfaqësimit të Shqipërisë në nivel ndërkombëtar në konsullata e ambasada, kudo që ne kemi përfaqësimet tona?

Kështu që me këto do të doja të jepja opinionin im.

Ju faleminderit!

Rudina Hajdari - Po, zonja Xhemali.

Adela Xhemali - Në lidhje me rënien e buxhetit në tërësi të Ministrisë për Punët e Jashtme, unë ju rikonfirmoj që është pikërisht ajo arsye që është shpjeguar edhe në Komisionin e Ekonomisë, është një fond të cilin vitin e kaluar ose për vitin 2020 e shtuam pikërisht për detyrimin që kishim si kryesues të OSBE-së dhe ky funksion mbaron. Meqenëse ky funksion mbaron, ai fond shtesë, që ishte i dedikuar për atë qëllim, është hequr. Nuk cenohet asnjë nga funksionet bazë të kësaj ministrie. Kjo ministri pastaj ka kërkesa të tjera, ka diskutime, por kjo është një çështje tjetër. Çështja që lidhet me shkurtimin ka të bëjë pikërisht me këtë, me faktorë të jashtëm, kishte faktorë njëherësh.

Rudina Hajdari - Deputeti Gjoni ka kërkuar fjalën.

Ralf Gjoni - Faleminderit!

Shkurtimisht, zonja kryetare, për sqarim për zonjën Mesi dhe për deputetët e nderuar anëtarë, unë nuk mendoj se ne duhet të kërkojmë llogari nga delegacioni i Komisionit Europian, por ne mund të kërkojmë informacion, sepse unë shoh në faqen zyrtare të delegacionit që në 6 vjetët e fundit, pra 2014-2020, që është asistencë financiare nën IPA II, që, në fakt, korrespondon pothuajse me 90% të qeverisjes socialiste, Bashkimi Europian ka dhënë 640 milionë euro. Këta i kanë ndarë në zëra dhe demokracia e mirëqeverisja kanë 208 milionë euro, sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore 133 milionë euro, nuk po shkoj... Është normale, zonja Mesi, që ne, si anëtarë, të duam të dimë se ku kanë shkuar këto 200 milionë euro në 6 vjet, ndërkohë që demokracia dhe qeverisja në Shqipëri janë përkeqësuar ndjeshëm, sipas të gjitha raporteve ndërkombëtare, por t'i lëmë raportet, se nuk kemi nevojë për raporte që ta dimë se çfarë tmerri po përjetojmë këtu nga ana e standardeve demokratike, në një vend ku ende diskutohet besueshmëria e votës, mosnumërimi i votës. Janë dhënë 200 milionë euro nga Bashkimi Europian dhe unë, si deputet, kam të drejtë të di se ku kanë shkuar këto para, kaq e thjeshtë, dhe ne kemi detyrim që, si komision,

të shohim se ku po shpërndahen dhe çfarë efikasiteti kanë fondet e dhuruara përtej buxhetit të shtetit shqiptar, fondet e alokuara nga Bashkimi European për aspekte të ndryshme të qeverisjes.

Tani, dhe doja të shtoja këtë që zonja Hyseni me shumë të drejtë e preku, jo pa qëllim e përmenda në diskutimin tim të parë faktin që duhet të dimë se sa kushton integrimi. Pse? Sepse vende si Serbia harxhojnë jashtëzakonisht shumë në një aspekt që ne e injorojmë, i cili quhet lobim. Shqipëria historikisht ka qenë jashtëzakonisht dobët në lobim. Lobimi, që në anglisht quhet *public affairs*, kushton shumë, dhe qeveritë shqiptare, jo vetëm qeveria aktuale, por edhe ajo e mëparshmja, gjithmonë kanë hezituuar për sa i përket rritjes së kapaciteteve lobuese të Republikës së Shqipërisë në botë, që, në fakt (të prek atë që tha zonja Hyseni), do të thotë fuqizim financiar i krahut diplomatik, i muskujve diplomatikë. Tani, kjo është një fushë që ndoshta e njoh më mirë se kushdo tjetër, pra punën e ambasadave, për shkak se kam punuar në atë ministri, por edhe kur kam qenë jashtë kam qenë shumë në kontakt me ambasadorë të ndryshëm.

A e dini ju, zonja Xhemali, dhe mos e merrni këtë si oponentë, por thjesht si diskutim, që një ambasador shqiptar tmerrohet kur duhet të ftojë një homolog të një vendi anëtar të BE-së për një drekë apo për një darkë? Le të themi, ambasadorja jonë në Bruksel ftohet nga ambasadori gjerman për një darkë; ajo e shkreta nuk ka fonde ta ftojë për një darkë, mendohet dy herë për ta ftuar edhe për një kafe. Dakord? Sepse me rrogat tmerrësisht të ulëta që marrin, me buxhetet tmerrësisht të ulëta që kanë ambasadat tona, buxhetet operative, ajo nuk ka fare mundësi për kapacitete lobuese dhe unë jam dakord me zonjën Hyseni, që, pavarësisht se ju keni bërë një ulje të fondeve për shkak se këto ishin fonde të parashikuara për drejtimin e OSBE-së, që, në fakt, nuk di çfarë kemi drejtuar për këtë vit, për shkak të pandemisë, Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, zonja Xhemali, duhet të jetë një ministri që duhet të ketë një prioritet dhe një vëmendje më të madhe nga qeveria shqiptare dhe nga Ministria e Financave, sepse është një ministri e veçantë, e cila duhet të pajiset me të gjitha nevojat e saj për të fuqizuar krahun diplomatik dhe krahun lobues.

Nuk duhet të harxhojmë para vetëm për avionë privatë të Kryeministrit e që të dalë nëpër intervista në Francë e në Belgjikë Kryeministri Rama, por ne duhet të fuqizojmë ambasadorët tanë dhe krahun diplomatik dhe të fillojmë të llojmë për vendin tonë, përndryshe nuk jeni asgjëkund. Në krahasim me Serbinë, për shembull, po ju them që jeni skandal, skandal! Aktualisht Serbia po kthen edhe trendin e luftës së Kosovës (mbajeni mend se çfarë do të ndodhë) dhe kjo ndodh sepse si ne, si Kosova, nuk harxhojmë para dhe, kur nuk dimë se sa kushton integrimi, lërë më të dimë

se sa nevojë kemi për të lobuar dhe çfarë parash kemi nevojë për të lobuar.

Kështu që unë i bashkohem kërkesës së kryetares. Neve na duhet të kemi një ide të përafërt, nuk po themi me saktësi, se sa kushton integrimi. Në qoftë se nuk keni mundësi, hajdeni të gjejnë një OJQ. Nga këto 200 milionë euro që jep Bashkimi European në 6 vjet, jam i sigurt që një OJQ me 3-4 të rinj, për 2 muaj kërkim në çdo institucion respektiv, mund të bëjë një përlllogaritje të përafërt se sa buxhet harxhon secili dikaster për integrimin, me një kalkulator të thjeshtë, në qoftë se nuk mbajnë mend tabelën e shumëzimit ose të shumimit, le ta bëjnë me plus, plus, plus, barabartë dhe nxjerr një shumatore se sa i kushton integrimi Shqipërisë dhe hajdeni të fillojmë të kemi një debat cilësor për sa u përket parave që alokohen dhe çfarë ne kemi mundësi të bëjmë me këto para. Flasim kot, vetëm raporte këtu, atje e të tjera, terma teknikë, kontabilitet, financa, por ndërkohë nuk flasim për terrenin.

Çdo hap që hedh një ambasador shqiptar apo një deputet shqiptar kushton para, dhe këtë e dinë zonja Hajdari dhe zonja Mesi, po ju drejtohem si bashkudhëtare tani, çdo hap që ne hedhim, çdo gotë verë që ne mund të pimë me një homolog në Parlamentin European kushton lekë, lobimi është luks. Kijeni parasysht këtë kur miratoni buxhete!

Faleminderit, zonja kryetare, dhe ndjesë që u zgjata pak!

Rudina Hajdari - Faleminderit, zoti Gjoni!

A ka ndonjë deputet tjetër që ka dëshirë të marrë fjalën?

Edhe unë u bashkohem komenteve të zonjës Hyseni, po ashtu edhe atyre të zotit Gjoni, që humbja e këtyre zërave vërtet mund të ketë një lloj kostoje dhe reflektimi, pra se sa shumë vëmendje ne i kushtojmë procesit të integritetit nga ana e qeverisë dhe është për të ardhur keq që kjo shifër është ulur vit pas viti, ndërkohë që e kundërta është e nevojshme.

Atëherë, mendoj se kemi ardhur drejt fundit.

Sot e kemi diskutimin thjesht në parim.

Do të kalojmë vetëm në votimin në parim.

Kush është pro këtij buxheti për vitin 2021? Kundër? Abstenim?

Në rregull, atëherë.

Miratohet.

Do t'ju njoftojmë për mbledhjen tjetër, ku do të kemi ministrin në detyrë, zotin Cakaj, i cili do të na informojë nën nën në lidhje me projektbuxhetin.

Ju faleminderit!

Ju uroj një ditë të mbarë dhe fundjavë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA